



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Kaçanik
Opština Kaçanik
Municipality of Kaçanik

Kryetari i Komunës

01-08Nr. 101/12.02.20

Kaçanik, 10.02.2020

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 Për Vetqeverisje Lokale, Rregulloren Komunale 2007/30, merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT KOMUNAL PËR VLERËSIMIN E DËMEVE TË SHKAKTUARA NË BUJQËSI NGA FATKEQËSITË NATYRORE DHE FAKTORËT TJERË

1. Me këtë vendim formohet komisioni Komunal për vlerësimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësitë natyrore (reshjet e shiut, borës, breshërit, erërat, ngricat e hershme etj) si dhe dëmet e shkaktuara nga egërsirat, (ujku, ariu, derri egër etj), në territorin e Komunës së Kaçanikut, me këtë përbërje:

1. Mustafë Loku, Zyrtar për Bujqësi dhe Blegtori
2. Arian Teneqja, Inxh. Ndërtimtarisë
3. Zekirja Koxha, Zyrtar për Zhvillim Rural

2 Komisioni ka për detyrë që sipas kërkesave të dalë në teren, vlerësoj dëmet e shkaktuara në bujqësi nga fatkeqësit natyrore (reshjet e shiut, borës, breshërit, erërat, ngricat e hershme, etj.) si dhe dëmet e shkaktuara nga egërsira (ujku, ariu, derri egër etj) dhe të hartoj raport me shkrim, me të cilin njoftohen Kryetari i Komunës dhe Drejtorja për Bujqësi, Zhvillim Rural dhe Pylltari.

3. Me këtë Vendim njoftohen: Arkivi i Komunës, DBZHRP-së, dhe Anëtarët e Komisionit.

Kryetari i Komunës

Besmir Ilazi



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës
Skupština Opština
Municipal Assambly

Nr. 104/02-2516 /20
Kaçanik;

Republika e Kosovës, Komuna e Kaçanikut, në bazë të nenit 13, 58 të Ligjit mbi Vetqeverisjen Lokale, nr. 03/L-040, nenit 73 të Statutit të Komunës së Kaçanikut, nenit 9 të rregullorës MF – 02/13 – Për Menaxhimin e Pasurisë Jofinanciare për Organizatat Buxhetore, Kryetari i Komunës së Kaçanikut merr këtë:

V E N D I M

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ASGJËSIMIN E SENDEVE TË CILAT JANË TË PA PËRDORSHME DHE TË PAVLEFSHME NË DEPO

1. Komisioni do të jetë në përbërje prej 3 anëtarëve edhe atë:
 - Besnik Dema
 - Menduh Rrahmani
 - Shefket Kuka
2. Anëtarëte komisionit duhet të asgjësojnë sendet të cilat janë të pa përdorshme dhe të pa vlefshme dhe që nuk i nënshtrohen ndonjë afati për ruajtje.
3. Në punën e tyre anëtarët e komisionit sipas pikës 2 të këtij vendimi, duhet të aplikojnë të gjitha procedurat standarte, ashtu siq kërkohen me dispozitat ligjore të cilat e rregullojnë këtë proces dhe në fund të përpilojnë raport, një raport t'i dërgohet edhe zyrtarit të pasurisë për ç'regjistrim të aseteve të cilat janë asgjësuar.
4. Antarët e komisionit duhet ta përfundojnë punën e tyre më së largu deri më 29.02.2020.

Me këtë vendim të njoftohen:

1. Anëtarët e komisionit,
2. Arkivi

Kaçanik më datë 18.02.2020

Kryetari i Komunës
Z. Besnik Ilazi

